

GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE TIRANË

Në mbështetje të Vendimit Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, shpall konkursin për pozicionin;

THIRRJE PËR APLIKIM SI KËSHILLTAR I JASHTËM PRANË DREJTORIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE

KOHËZGJATJA

12 muaj

Galeria Kombëtare e Arteve, në kuadër të funksionalizimit të plotë të hapësirave ekspozuese pas rikonstruksionit të godinës dhe zbatimit të linjës muzeale, shpall thirrje të hapur për angazhimin e një Këshilltari të Jashtëm për mbështetje teknike dhe hapësinore në realizimin e projektit ekspozues të linjës muzeale.

I. Qëllimi i Angazhimit

Qëllimi i kësaj thirrjeje është angazhimi i një Këshilltari të Jashtëm me profil teknik, i cili do të mbështesë institucionin në fazën e zbatimit praktik të projektit ekspozues për linjën muzeale, duke siguruar përkthimin e koncepteve kuratoriale të miratuara në zgjidhje konkrete teknike, funksionale dhe estetike, në përputhje me standardet muzeale.

Angazhimi ka karakter këshillimor dhe teknik, është i përkohshëm dhe nuk mbivendoset me funksionet administrative apo menaxheriale të stafit të brendshëm të institucionit.

II. Detyrat e Këshilltarit të Jashtëm

Këshilltari të Jashtëm do të ketë këto detyra kryesore:

1. Konkretizimi i pozicionimit të veprave në hapësirat ekspozuese, në përputhje me listat e veprave të miratuara, projektin kuratorial dhe projektin arkitektonik/ekspozues të linjës muzeale.

2. Përgatitja e planimetrive të vendosjes së veprave, duke përcaktuar pozicionimin e tyre në raport me hapësirën ekspozuese, qarkullimin, panelet, raftet, podet dhe elementët e tjerë të ekspozimit.
 3. Përgatitja e fasadave të brendshme (planeve murale) ekspozuese, me përcaktimin e lartësive të vendosjes, distancave ndërmjet veprave, marrëdhënies vizuale me hapësirën dhe koordinimit me sistemet e fiksimit dhe ndriçimit.
 4. Vlerësimi teknik i elementëve ekspozues, duke analizuar përshtatshmërinë e paneleve, rafteve, podeve, sistemeve të fiksimit dhe elementëve të tjerë në funksion të karakteristikave dhe kërkesave të secilës vepër.
 5. Propozimi i përshtatjeve teknike të zgjidhjeve ekzistuese, sipas pozicionimit përfundimtar të veprave, për garantimin e funksionalitetit, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe koherencës estetike të ekspozimit.
 6. Mbështetja në kërkimin dhe verifikimin teknik të materialeve për modulet ekspozuese dhe elementët mbajtës ose prezantues, si dhe propozimi i alternativave të përshtatshme në rast mungese ose pamundësie furnizimi me materialet e parashikuara.
 7. Përgatitja e dokumentacionit teknik zbatues, që përfshin planimetritë, fasadat e brendshme, detajet e montimit, sistemet e fiksimit, ndriçimin, specifikimet e materialeve dhe përshtatjet teknike të nevojshme për realizimin e linjës muzeale.
 8. Përgatitja e raportit përfundimtar të këshillimit, që përmbledh aktivitetet e kryera, vlerësimet teknike, problematikat e evidentuara, zgjidhjet e propozuara ose të zbatuara, verifikimin e materialeve dhe rekomandimet për vijimin e realizimit të linjës muzeale.
- Detyrat e mësipërme nuk përfshijnë funksione menaxheriale, administrative apo vendimmarrëse.

KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për këtë pozicion;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si më poshtë:

- Duhet të ketë arsimin e lartë në fushën e Arkitekturës, Arkitekturë Interier dhe Design, Master Shkencor ose ekuivalent;
- Të kenë përvojë profesionale në zbatimin teknik dhe hapësinor të projekteve ekspozuese, muzeale ose kulturore;
- Të zotërojnë njohuri mbi materialet ndërtimore, sistemet e ekspozimit, ndriçimin muzeal dhe detajimin teknik;
- Të kenë aftësi për të punuar mbi projekte kuratoriale të miratuara dhe për t'i përkthyer ato në zgjidhje konkrete realizimi;
- Të kenë përvojë në mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve nga këndvështrimi i dizajnit të brendshëm dhe funksionalitetit hapësinor;
- Të ketë aftësi për t'u përshtatur me kushtet, teknologjinë dhe procedurat e reja të standarteve evropiane;
- Të zotërojnë gjuhën Angleze;
- Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në rrjet/system, Internet, programe dhe softë, Paketa Microsoft Windoës (Word, Exel, PowerPoint) etj. Njohja e programeve të tjera përbën avantazh;
- Të ketë aftësi të mira për përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrimi i aplikantit;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të diplomës;
- Fotokopje të listës së notave;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Çertifikata kualifikimi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet bërë brenda datës 29.07.2026, nëpërmjet postës zyrtare, dorazi në Zyrën e Protokollit të Galerisë Kombëtare të Arteve, në adresën: Ruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76, ish Kinostudio, godina “Albafilm”, Tiranë, Shqipëri apo me postë elektronike në adresën elektronike të Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë, info@galeriakombetare.gov.al

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe intervista të drejtpërdrejta.

Konkurimi do të zhvillohet në datë 30.07.2026 ora 10:00, në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve, në adresën: Ruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76 ish Kinostudio, godina “Albafilm”, Tiranë, Shqipëri.

VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidatëve do të kryhet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Komisioni do të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikimet sipas kritereve të përcaktuara në këtë shpallje

SHPALLJA E REZULTATEVE

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet nëpërmjetadresës së e-mail-it të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

